

RAPORT PER AUDITIMIN E FONDEVE TE SHPENZUARA NGA PARTIA  
DREJTAVE TE MOHUARA, NE FUSHATEN E ZGJEDHJEVE VENDORE TE  
DATES 21 QERSHOR 2015

DREJTUAR: KOMISIONIT QENDROR TE ZGJEDHJEVE

TIRANE

Une, Qani Kajo, Ekspert Kontabel i Regjistruar, me licence profesionale nr.076 date 20.03.2000 dhe Nipt K37810309H, ne baze te kontrates se sherbimit, nr.7750 date 05.10.2015, te lidhur me KQZ, me objekt “Auditimi i fondeve te shpenzuara prej Partive Politike qe moren pjese ne fushaten e zgjedhjeve vendore te dates 21.06.2015”, kam nderin t`ju paraqes raportin e auditimit per Partine Drejtave te Mohuara.

Auditimi u krye ne baze te ligjit 8580 date 17.02.2000 “Per partite Politike”, i ndryshuar me ligjin 10374 date 10.02.2011. Gjitashtu auditimi u krye ne baze te ligjit 10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin te profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontablit te Miratuar” si dhe ligjit 9228 date 29.04.2004 “Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Auditimi kryhet gjithashtu , ne baze te vendimit nr.969 date 10.08.2015 te KQZ-se sipas shortit te hapur publikisht.

Duke u mbeshtetur ne bazen ligjore te mesiperme, une, auditova fondet e shpenzuara nga Partia e te Drejtave te Mohuara, me kyetar zotin Ilir Vata.

Per kete qellim mora kontakt me kryetarin e Partise dhe finacierin e kesaj partie, hartuam aneks kontraten per kryerjen e auditimit dhe u krijuan te gjitha kushtet per kryerjen e ketij auditimi pa asnje pengese.

Kryetari i Partise deklaroi se kishte marre fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit sipas ndarjes se bere. Fonde nga donator, subjekte juridike dhe individe, nuk kishin pasur per fushate.

Gjthsej ne llogarite e Partise kishin hyre nga buxheti i shtetit, shuma **83.333** leke. Partia per fushaten e zgjedhjeve kishte bere shpenzime te ndryshme per; shpenzime

per ditën e fushatës, fonde të cilat i kishte shpërndarë nëpërmjet kordinatorëve , për komisionerët dhe vezhguesit në qendrat e votimit, shpenzime për flamuj, për posterë të ndryshëm, banderolë, fletë votimi treguese, parrulla, printime në adeziv, për kandidatët në garë dhe për votuesit e Partisë, shpenzime për publicitet në media dhe shpenzime të vogla për karburante e pritje përcjellje, duke bërë shpenzime të ndryshme për elektoratin.

Të gjitha shpenzimet e kryera ishin bërë me dokumenta të rregullta që plotësonin kushtet e ligjshmerisë tatimore, fatura të biznesit vogël dhe pagesat ishin bërë me likuidim në banka sipas procedurave tatimore.

Në rastin e këtij subjekti, këto shpenzime nuk përbenin materialitet për të deformuar gjendjen e administrimit.

## **Opinion**

**Sipas opinionit tim si audit, Partia Drejtave të Mohuara, ka zbatuar kërkesat e ligjit 8580 datë 17.02.2000 “Për partitë Politike”, i ndryshuar me ligjin 10374 datë 10.02.2011, për përdorimin e fondeve të përfituara nga buxheti i shtetit për fushatën e zgjedhjeve lokale 21.06.2015.**

Une si audit, duke u bazuar në kërkesat e ligjit për auditimin dhe në të gjitha ligjet në fushën e tatimeve dhe të mbajtjes së kontabilitetit, gjykoj se Partia Drejtave të Mohuara, ka zbatuar të gjitha rregullat për të përdorur drejt fondet e dhëna nga buxheti.

Ky raport auditimi hartohet në tre kopje si dhe në format elektronik dhe mund të përdoret për gjithë të interesuarit.

Ekspert Kontabel I Regjistruar

Qani KAJO

Rruga “Hamid Shijaku” Pall. Protial

Nr.kontakti Mob 0692070915